



Pranuar / Dostiguar Pamlyena / Protolito Received / Delivery	26.07.2022	2 viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtujca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	4329/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.525/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.525/2022 të datës 13.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit/Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.525/2022 e datës 13.06.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 2321 i datës 06.06.2022 i Menaxheres së Personelit.

A r s y e t i m

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me njoftimin e datës 04.05.2022 ka shpallur konkursin e brendshëm të datës 19.05.2022 me numër referencë RN00008901 për "Lëvizje brenda kategorisë Profesional 1" për vendin e punës "Zyrtar i Lartë i Pagesave Direkte", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Sipas vendimit me numër 2243 të datës 31.05.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, ankuesit iu është refuzuar aplikacioni me kodin me numër RAN0004964. Ankuesi i pa kënaqur më këtë vendim me datë 02.06.2022 parashtron ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me datë 06.06.2022 merr vendim me numër 2321 me të cilin vendim e refuzon si të pa bazuar ankesën e datës 02.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

Ankuesi i pakënaqur me Vendimet e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me datë 09.06.2022 ka parashtruar ankesë nëpërmjet Postës së Kosovës ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 13.06.2022 me numër të protokollit 3405/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitive Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 17.06.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë. Me datë 15.07.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencina për Zhvillimin e Bujqësisë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit datës 13.06.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi i datës 19.05.2022; Aplikacioni i [] me dokumentacionin e bashkëngjitur (përgatitja profesionale dhe përvoja e punës); Akt emërimi i ankuesit; Formulari i vlerësimit të rezultateve të punës për ankuesin për vitin 2021, Vërtetimi nga njësia e Burimeve Njerëzore e datës 27.05.2022; Lista e Aplikantëve; Vendimi i datës 31.05.2022 i Menaxheres së Personelit; Për listën e shkurtë e datës 31.06.2022 e Menaxheres së Personelit; Ankesa e ankuesit e datës 02.06.2022 e parashtruar në organin e punësimit; Vendimi i datës 06.06.2022 i Menaxheres së Personelit si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se mos përfshirja në listën e shkurtë nga ana e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë është i pa bazuar pasi që ankuesi pretendon se i ka plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit për sa i përket përgatitjes së arsimit më tutje pretendon se i ka pikët e kredive sipas konkursit të datës 19.05.2022 pasi që nga studimet themelore ka 180 kredi dhe nga masteri 91 kredi që gjithsej janë 271 kredi dhe se e ka përmbushur kriterin për sa i përket përgatitjes së arsimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka konstatuar se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me njoftimin e datës 04.05.2022 ka shpallur konkursin e brendshëm nga data 19.05.2022 deri më 30.05.2022 me numër reference RN00008901 për "Lëvizje brenda kategorisë Profesional 1" për vendin e punës "Zyrtar i Lartë i Pagesave Direkte", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi [] bazuar në dispozitat e nenit 38 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Sipas njoftimit të konkursi të datës 04.05.2022 me afatin për aplikim nga data 19.05.2022 deri më 30.05.2022 me numër reference RN00008901 për "Lëvizje brenda kategorisë Profesional 1" për



vendin e punës “Zyrtar i Lartë i Pagesave Direkte”, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor”;
Kualifikime të posaçme: Universiteti i Bujqësisë, Ekonomik, Juridik e tjera;

Përvoja e punës së kërkuar: së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës; ndërsa dokumentet që duhet të paraqitur për aplikim janë: “Kopja e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; Kopja e dëshmisë së punësimit; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit; Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar njembdhjete (11) kandidatë, ne mesin e tyre edhe ankuesi i cili për këtë pozitë të punës, ka aplikuar me numër reference me kodin me numër RAN0004964, ndërsa me datë 31.05.2022 Njësia e Burimeve Njerëzore ka nxjerrë vendimin me numer 2243 me të cilin ka refuzuar aplikacionin e [] i cili nuk kualifikohet për procedurat e mëtejme të rekrutimit sepse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 45 paragrafit 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në bazë të dokumentacionit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se sipas aplikacionit të ankuesit me numër të kodit RAN0004964, ankuesi me rastin e aplikimit për sa i përket përgatitjes së arsimit ka dorëzuar Diplomën me numër 150 të datës 26.03.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, me të cilën dëshmohet se [] me datë 30.09.2011 mbaroi studimet themelore universitare në Drejtimin e Agroekonomisë dhe mori titullin “Baçelor i Agroekonomisë”, po ashtu ankuesi ka bashkangjitur pasqyrën e notave me numër të protokollit 04-394 të datës 28.04.2022 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë andaj edhe sipas vendimit me numër të protokollit 2243 të datës 31.05.2022 të nxjerrë nga Menaxherja e Personelit iu është refuzuar aplikacioni i ankuesit [] për procedurën e lëvizjes brenda kategorisë me numër të referencës RN00008901 në Agjencinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit për pozitën “Zyrtar i Lartë i Pagesave Direkte”.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se i ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale për sa i përket arsimit sipas konkursit të datës 19.05.2022, Kolegji ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit nuk është i bazuar andaj organi i punësimit me mos përfshirje në listë të ngushtë të ankuesit Gani Kerolli ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 45 paragrafit 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, që ka përcaktuar se: **“4. Kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire renditen në një listë të shkurtër në rendin alfabetik. Lista e shkurtër shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve. 5. Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve”**, sepse ne rastin konkret Menaxherja e Personelit në bazë të dokumentacionit ka nxjerrë

vendimin me numër protokollit 2243 të datës 31.05.2022 me të cilin iu është refuzuar aplikacioni i ankuesit [redacted] pasi që i njëjti nuk ka ofruar dëshmi respektivisht „Diplomë” me të cilën dëshmohet se ankuesi ka përfunduar studimet Master dhe ka fituar titullin „Magjistër i Shkencave” sipas kërkesave të përgjithshme formale të konkursit të datës 19.05.2022 ku është theksuar specifikisht se: *“kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë: “Arsinimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor”* por ka dorëzuar vetëm pasqyrën e notave.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Menaxherja e Personelit me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër të protokollit 2321 të datës 06.06.2022 ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.525/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit të Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.